



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**MINISTRI**

Nr. 4285 prot.

Tiranë, më 4.5.2018

Lënda: Dërgim model certifikate

**Z. AGIM ISMAILI**  
**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**  
**AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT**

**Tiranë**

I nderuar Z. Ismaili,

Bashkëlidhur, po iu dërgojmë modelin e certifikatës shëndetësore për molusqet bivalve të destinuar për konsum njerëzor, e cila do të përdoret nga inspektorët e AKU-së gjatë certifikimit të ngarkesave me molusqet bivalve të destinuar për konsum njerëzor, për tregëtim në tregun e brendshëm.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

CERTIFIKATË SHËNDETËSORE PËR MOLUSQET BIVALVE PËR KONSUM HUMAN

1.1. Emri i dërguesit  Adresa: Nr. Tel.	1.2. Numri i referencës së certifikatës:
	1.3. Autoriteti kompetent qendror:
	1.4. Autoriteti kompetent lokal:
1.5. Marrësi i ngarkesës Emri: Adresa: Tel. Nr.	1.6.
1.7. Vendi origjinës Emri: Adresa: Numri i aprovimit:	1.8.
1.9. Vendi ngarkimit:	1.10. Data e nisjes :
1.11. Mjetet e transportit:  Identifikimi/ numri i vulës:	1.12. Depuruar: Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
	1.13.
1.14. Përshkrimi i mallit:	1.15. Sasia:
1.16. Temperatura e produktit Ambjenti <input type="checkbox"/> I freskët <input type="checkbox"/> I ngrirë <input type="checkbox"/>	1.17. Numri i pakove
1.18. Tipi i ambalazhit:	
1.19. Mall i certifikuar për: Konsum human <input type="checkbox"/>	
1.20. Identifikimi i mallit:  Numri i aprovimit të stabilimentit:	
Specia, emri shkencor:      Natyra e mallit:      Fabrika përpunuese:      Numri i pakove :      Pesha neto:	

## II.1 Deklaratë e shëndetit publik :

Unë i nënshkruari, deklaroj që jam i informuar në lidhje me kërkesat e ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin", i ndyshuar, udhëzimit nr. 21, date 25.11.2010 "Mbi kërkesat specifike të higjenes dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore", udhëzimit nr. 22, date, 25.11.2010 "Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjenes për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor", si dhe udhëzimit nr. 25 datë 25.11.2010 "Për kushtet higjienike dhe kontrollet për molusqet e gjalla bivalvore, peshkun dhe produktet e peshkimit" dhe vërtetoj se molusqet bivalve të përmendura më sipër janë prodhuar në përputhje me këto kërkesa, në vecanti vërtetoj që ato:

- vijjnë nga një stabiliment që zbaton një program të bazuar në principet e HACCP-it, sipas udhëzimit nr. 20 datë 15.11.2010 "Për zbatimin e programeve paraprake, të praktikave të mira të higjenes, praktikave të mira të prodhimit dhe procedurave të bazuara në analizën e rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP) në stabilimente ushqimore",
- janë kapur, aty ku është e nevojshme, transportuar dhe përputhur me kërkesat e vendosura në udhëzimin nr. 25 datë 25.11.2010 "Për kushtet higjienike dhe kontrollet për molusqet e gjalla bivalvore, peshkun dhe produktet e peshkimit",
- përmbushin standartet shëndetësore të vendosura mbi kriteret mikrobiologjike të ushqimeve, të përcaktuara në urdhrin nr. 645 datë 23.12.2016 për zëvendësimin e aneksit I, të urdhrin nr. 234, datë 20.05.2014, për miratimin e rregullores "Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore",
- janë trajtuar aty ku është e nevojshme janë pastruar duke kaluar procesin e depurimit dhe janë paketuar në përputhje me standartet e legjisllacionit në fuqi,
- janë paketuar, magazinuar dhe transportuar në përputhje me standartet e përcaktuara në udhëzimin nr. 25 datë 25.11.2010 "Për kushtet higjienike dhe kontrollet për molusqet e gjalla bivalvore, peshkun dhe produktet e peshkimit",
- janë tregtuar dhe etiketuar në përputhje me legjisllacionin në fuqi,
- në rast kur janë kapur *Pectinidea* jashtë zonës të klasifikuar si zone prodhimi, përputhen me kërkesat e vendosura në udhëzimin nr. 25 datë 25.11.2010 "Për kushtet higjienike dhe kontrollet për molusqet e gjalla bivalvore, peshkun dhe produktet e peshkimit", dhe
- i janë nënshtruar me sukses kontrolleve zyrtare .

## II.2 Deklaratë e shëndetit të kafshëve:

Unë, i nënshkruari, deklaroj, se molusqet bivalve të gjallë të përshkruara më sipër, origjinojnë nga burime ku nuk ka vdekshmëri anormale të pazgjidhur në popullatën e molusqeve, certifikoj, në veçanti që:

- nëse origjinojnë nga lloje të prekshme të infeksioneve *Bonamia exitiosa*, *Mikrocytos roughleyi*, *Marteilia Sydneyi*, *Mikrocytos mackini*, *Perkinsus marinus*, *P. olseni/atlanticus*; *Haplosporidium nelsoni*, *H. costale dhe/ose Candidatus Xenohaliotis californiensis*, ato:
  - kanë origjinën nga burim i konsideruar i lirë nga bonamiosis (*Bonamia exitiosa dhe Mikrocytos roughleyi*); marteiliosis (*Marteilia sydneyi*); mikrocytososis (*Mikrocytos mackini*); perkinsosis (*Perkinsus marinus dhe P. olseni / atlanticus*); haplosporidiosis (*Haplosporidium nelsoni dhe H. costale*) dhe Withering Sindrom (*Candidatus Xenohaliotis californiensis*) në përputhje me legjisllacionin përkatës ose standardin e OIE-së,
- janë dërguar si produkte të papërpunuara ose të përpunuara,
- nëse origjinojnë nga lloje të prekshme ndaj infeksioneve me *Marteilia refringens* ose *Bonamia ostrea*, ata:
  - kanë origjinën nga burim i konsideruar i lirë nga *Marteilia refringens / Bonamia ostrea* në përputhje me legjisllacionin përkatës ose standardin e OIE-së.
  - janë dërguar si produkte të papërpunuara ose të përpunuara,

Inspektori zyrtar i AKU-së

Emri me gërma shtypi \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_

Vula

Kualifikimi dhe titulli: \_\_\_\_\_

Firma \_\_\_\_\_